

Mirë për ta ditur

Me mbërritjen tuaj në kantonin Jura
Oraret e hapjes të dyqaneve dhe festat zyrtare
Autorizimet (ose lejet) e qëndrimit
Sigurimi i përgjegjësisë civile
Drogat, alkooli dhe duhani
Kafshët shtëpiake
Rregullat dhe zakonet në Zvicër

Me mbërritjen tuaj në kantonin Jura

Në këtë kapitull, do të gjeni informacione të rëndësishme, por në fushashumë të ndryshme të jetës, për shembull, në lidhje me: çfarë duhet të bëni, kur të mbërrini në kantonin e Jura-sëoraret e hapjes së dyqaneve dhe festat zyrtareautorizimet e ndryshme të qëndrimit (ose leje qëndrimi)sigurimin e përgjegjësisë civile drogat, alkoolin dhe duhaninkafshët shtëpiakerregullat dhe zakonet në Zvicër

Çfarë duhet bërë me mbërritjen tuaj në Jura?

Paraqituni në kontrollin e banorëve të komunës tuaj

Kërkoni një autorizim (leje) qëndrimi

Regjistroni fëmijët tuaj në shkollë nëse janë nën moshën 16-vjeçare

Bëni një kontratë me një sigurim shëndeti

Kërkoni një leje pune

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.bonjour-jura.ch/sq/mire-per-ta-ditur/me-mberritjen-tuaj-ne-kantonin-jura

Oraret e hapjes të dyqaneve dhe festat zyrtare

Në Zvicër, shumica e dyqaneve janë të mbyllura të dielën dhe ditët e festave zyrtare, përveç dyqaneve të stacioneve dhe pompat e benzinës. Festat zyrtare ndryshojnë sipas kantoneve.

Festat zyrtare

Festat zyrtare janë si një ditë e diel. Në kantonin e Jura-së, festat zyrtare janë këto:

- 1 janar: Viti i Ri
- 2 janar: E nesërmja e Vitit të Ri
- E premtja e shenjtë (e premtja para Pashkëve)
- E hëna e Pashkëve (e hëna pas Pashkëve)
- 1 maj: Festa e Punës
- E enjtja e Shëlbuemit (40 ditë pas të dielës së Pashkëve)
- E hëna e Rrëshajës (50 ditë pas të dielës së Pashkëve)
- E enjtja e Festës së Korpit dhe Gjakut të Krishtit (60 ditë pas të dielës së Pashkëve)
- 23 qershor: në kujtim të 23 qershorit 1974, dita kur populli jurasian votoi për krijimin e kantonit të Jura-së (Referendumi jurasian).
- 1 gusht: Festa kombëtare e Zvicrës
- 15 gusht : Ngritja e Shën Marisë
- 1 nëntor : Dita e Shenjtorëve
- 25 dhjetor : Krishtlindja

Në distriktin Porrentruy, e hëna e St-Martin (e hëna e 2-të ose e 3-të pas 1 nëntorit) është po ashtu ditë feste.

Oraret e hapjes së dyqaneve

Kantonet rregullojnë oraret e hapjes së dyqaneve.

Në kantonin e Jura-së, dyqanet janë të hapura zakonisht nga e hëna deri të premten nga ora 8:00 deri në orën 18:00 dhe të shtunën nga ora 8:00 deri në orën 17:00.

Disa dyqane janë të hapura deri në orën 21:00 të enjten dhe të premten.

Dyqanet e stacioneve dhe pompat e benzinës janë të hapura 7 ditë në 7.

Disa dyqane fshati janë të hapura edhe të dielën në mëngjes.

Oraret e hapjes të shërbimeve publike

Shërbimet e kantonit janë zakonisht të hapura nga e hëna deri të premten prej orës 8:00 deri në 11:30 dhe prej orës 14:00 deri në 16:30. Oraret e shërbimeve të komunave (për shembull, oraret e zyrës komunale) mund të ndryshojnë, këshillohet të verifikohen paraprakisht.

Sportelet virtuale

Gjithnjë e më shumë shërbime kantonale dhe komunale janë të disponueshme online 24 orë në 24 dhe 7 ditë në 7. Shumë shërbime mund të jenë në qasje në Internet.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.bonjour-jura.ch/sq/mire-per-ta-ditur/oraret-e-hapjes-te-dyqaneve-dhe-festat-zyrtare

Autorizimet (ose lejet) e qëndrimit

Për të jetuar ose punuar në Zvicër është i nevojshëm një autorizim qëndrimi. Ka lloje të ndryshme autorizimesh. Flitet gjithashtu për leje qëndrimi.

Forma të ndryshme autorizimi

Çdo person që jeton në Zvicër për më shumë se 3 muaj ose punon aty ka nevojë për një autorizim.

Kushtet janë të ndryshme për personat që kanë shtetësinë e një shteti të Bashkimit Evropian (BE)/AELE (EFTA) dhe personat që kanë shtetësinë e shteteve të tjera (jashtë Bashkimit Evropian dhe AELE(EFTA)).

Ky autorizim jepet nga Shërbimi i Popullsisë i kantonit të Jura-së. Ja një tabelë që përmbledh format e autorizimeve.

Për kërkuesit e azilit:

Personat që jetojnë në Zvicër për të kërkuar asile kanë leje të tjera.

Leja për të huajt

Të huajt që jetojnë në Zvicër marrin një leje. Kjo leje mund të jetë ndryshe nga një person tjetri, sipas disa kriterëve (për shembull, shteti i origjinës).

Të gjitha lejet jepen në formën e kartës biometrike.

Për të bërë lejen, personat duhet të shkojnë në Bureau des passeports (Zyrën e pasaportave) në Delémont dhe të japin të dhënat biometrike (shenjat e gishtave dhe foto).

Vjedhja ose humbja e lejes duhet të njoftohet menjëherë në polici.

Zgjatja /ripërtëritja e lejes së qëndrimit

Për të ripërtëritur autorizimin tuaj, ka disa hapa sipas statusit dhe shtetësisë suaj. Ju do të merrni një formular për të plotësuar. Duhet ta dërgoni këtë formular para përfundimit të afatit. Ripërtëritja nuk është automatike. Ka disa kushte. Për shembull: mësimi i frëngjishtes.

Nganjëherë ripërtëritja refuzohet. Për shembull nëse:

- personi ka kryer një vepër penale
- personi merr ndihmë sociale për një kohë të gjatë

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.bonjour-jura.ch/sq/mire-per-ta-ditur/autorizimet-ose-lejet-e-qendrimit

Sigurimi i përgjegjësisë civile

Çdo i rritur duhet të ketë një sigurim të përgjegjësisë civile. Ky sigurim mbulon shpenzimet nëse i shkaktoni ndonjë dëm dikujt ose diçkaje aksidentalisht.

Përgjegjësia vetjake

Nëse plagosni dikë ose dëmtoni sendet e tij pa dashje, ju jeni përgjegjës financiarisht. Për shembull, nëse plagosni dikë duke bërë sport, shpenzimet mund të jenë shumë të larta. Dhe nëse nuk keni sigurim, ju vetë duhet të paguani.

Sigurimi i përgjegjësisë civile

Në rast dëmi, është e rëndësishme të keni një sigurim të përgjegjësisë civile. Kështu, sigurimi paguan një pjesë të madhe të shpenzimeve. Shumica e kompanive private të sigurimit e propozojnë këtë sigurim. Ai është i vlefshëm për të gjithë personat që jetojnë në të njëjtën banesë.

Edhe pse nuk është e detyrueshme, është shumë e këshilluar të keni një sigurim të përgjegjësisë civile.

Çfarë paguan sigurimi?

Ky sigurim paguan për dëmet materiale (mbi sendet) dhe trupore (mbi trupin) të shkaktuara ndaj personave të tjerë.

Ai paguan shpenzimet e riparimit, shpenzimet mjekësore, humbjen e pagës ose kompensimin financiar. Ai mund të mbulojë dëmet e shkaktuara nga disa kafshë shtëpiake. Në të kundërt, ai nuk paguan nëse dëmet prekin persona që jetojnë në të njëjtën banesë. Dëmet, të cilat i shkaktojmë vullnetarisht ose për shkak të një gabimi të rëndë, nuk paguhen.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.bonjour-jura.ch/sq/mire-per-ta-ditur/sigurimi-i-pergjegjesise-civile

Drogat, alkooli dhe duhani

Është e rëndësishme të respektoni ligjet mbi drogat, alkoolin dhe duhanin. Ja çfarë duhet të dini:

Drogat

Sipas ligjit federal mbi lëndët narkotike, është e ndaluar mbajtja, shitja ose konsumimi i drogave ilegale. Dhe kjo edhe në sasi të vogla.

Nëse dikush bën tregti të drogës, ka masa ndëshkuese të rënda

Alkooli dhe duhani

Shitja e alkoolit dhe duhanit është e kufizuar sipas moshës. Në kantonin e Jura-së:

- është e ndaluar t'u shiten pije alkoolike të rinjve nën 16 vjeç
- është e ndaluar t'u shitet duhan dhe alkool i fortë të rinjve nën 18 vjeç.

Ndalimi i pirjes së duhanit

Për vendet ku është e ndaluar pirja e duhanit ka rregulla të rrepta.

Këto rregulla shërbejnë për të mbrojtur shëndetin e të gjithëve.

Është e ndaluar të pihet duhan në:

- në hapësirat publike të mbyllura (spitale, administrata, shkolla, muze, kinema, teatro, trena dhe autobusë, dyqane dhe qendra tregtare)
- në ambientet ku punojnë shumë njerëz

E drejta për të pirë duhan në restorante varet nga madhësia e restorantit. Në shumë restorante, gjendet një sallë e posaçme për të pirë duhan. Ajo quhet: dhomë për të pirë duhan.

Për disa persona, është e vështirë të ndalojnë pirjen e duhanit ose marrjen e drogave.

Këta persona kanë varësi (nga duhani, nga droga, etj.). Ju gjeni informacione mbi ndihmat e mundshme dhe parandalimin e varësive: për shembull shërbimet e ndihmës dhe organizatat e mbështetjes.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.bonjour-jura.ch/sq/mire-per-ta-ditur/drogat-alkooli-dhe-duhani

Kafshët shtëpiake

Nëse keni kafshë në shtëpinë tuaj, duhen respektuar disa rregulla. Disa kafshë nuk mund të mbahen në apartament. Pronarët e qenve duhet të paguajnë një taksë për çdo qen.

Mbajtja e kafshëve shtëpiake

Në apartamentet me qira, qiramarrësit mund të kenë kafshë shtëpiake të vogla, si kavje, hamstera, kanarina ose peshq.

Në të kundërt, pronarët mund të ndalojnë, në kontratën e qirasë, të keni kafshë më të mëdha, si macet ose qentë. Pronari mund të ndalojë gjithashtu kafshë të zhurmshme ose të rrezikshme. Para se të merrni një kafshë, duhet t'i kërkonit leje pronarit të apartamentit.

Pronarët e kafshëve duhet të respektojnë ligjet federale mbi mbrojtjen e kafshëve. Për shembull, për disa specie, nuk mund të mbahet një kafshë vetëm (për shembull lepujt) ose duhen kafaze mjaft të mëdha.

Disa kafshë (kafshë ekzotike) nuk kanë të drejtë të hyjnë në Zvicër. Për kafshë të tjera, duhet një autorizim i posaçëm nga Service de la consommation et des affaires vétérinaires (SCAV) (Shërbimi i konsumit dhe çështjeve veterinare).

Qentë

Në kantonin e Jura-së, ekzistojnë rregulla të posaçme për qentë:

- Të gjithë qentë duhet të kenë një çip elektronik nën lëkurë. Gjithashtu, ata duhet të jenë të regjistruar. Pronari merr një kartë identiteti për qenin e vet.

Kujdes, kjo kartë nuk është pasaporta për kafshët shtëpiake e përdorur gjatë udhëtimeve jashtë vendit.

- Qentë duhet të jenë të regjistruar në komunën e vendbanimit. Çdo vit duhet të paguhet një taksë.
- Pronarët e qenve duhen të mbledhin jashtëqitjet e kafshës së tyre.

Nëse jo, mund të gjobiten.

- Këshillohet të ndiqen kurse të trajnimit për qentë.
- Për të pasur qen të disa racave, si Pitbull ose Rottweilers, duhet një autorizim i posaçëm.

Veterineri ose veterinerja është në dispozicion për çdo informacion.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.bonjour-jura.ch/sq/mire-per-ta-ditur/kafshet-shtepiake

Rregullat dhe zakonet në Zvicër

Secili vend i ka rregullat dhe zakonet e veta. Edhe në Zvicër ka disa rregulla të pashkruara. Është e rëndësishme që ato të respektohen.

Kulturat e ndryshme

Zvicra është një vend i larmishëm me rajonet e ndryshme të saj dhe me katër gjuhët kombëtare. Mentaliteti dallon sipas rajoneve. Një zakon në Zvicrën romande mund të jetë ndryshe në pjesën gjermane ose italiane të Zvicrës. Dallimet ndërmjet qyteteve dhe fshatrave janë po ashtu të rëndësishme. Por ka edhe zakone të ngjashme për të gjithë Zvicrën:

Përshëndetjet

Në Zvicër, kur përshëndeten, njerëzit shtrëngojnë duart dhe shihen në sy, edhe mes burrave dhe grave. Shpesh përdoret "Bonjour" ("Mirëdita") si përshëndetje standarde, por ndërmjet miqve, mund të thuhet "Salut" ("Përshëndetje"). Në fshatra, në përgjithësi, njerëzit përshëndeten, edhe nëse nuk njihen.

Është e rëndësishme gjithashtu të thuash "Merci" ("faleminderit") dhe "de rien" ("s'ka për se"), edhe në dyqane dhe restorante.

Përpikëria

Përpikëri do të thotë: të mbërrish në kohë.

Në Zvicër, në përgjithësi, njerëzit arrijnë në kohë.

Nëse jeni më shumë 5 minuta me vonesë, është e sjellshme të lajmëroni me telefon ose me SMS. Kjo është e rëndësishme sidomos në punë.

Për mbledhjet ose takimet, është më mirë të caktohet ora paraprakisht.

Vizitat pa lajmërim nuk janë të zakonshme, edhe mes miqve.

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.bonjour-jura.ch/sq/mire-per-ta-ditur/rregullat-dhe-zakonet-ne-zvicer